



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 17.2.2021

R A P O R T

**PËR AKTIN NORMATIV NR.4, DATË 5.2.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.137/2020, “PËR BUXHETIN E VITIT
2021”**

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 17 shkurt 2021, shqyrtoi aktin normativ nr.4, datë 5.2.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”. Akti normativ u shqyrtua sipas rregullave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relator, për këtë akt normativ, z. Anastas Angjeli.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të ftuar, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Znj. Anila Denaj, Ministre;
- Znj. Adela Xhemali, Zëvendësministre;
- Z. Gentian Opre, Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor;
- Znj. Xhoana Agolli, Drejtore e Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit.

II. Baza ligjore.

Akti normativ është paraqitur për miratim nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në bazën kushtetuese e ligjore, si më poshtë:

- nenet 101 dhe 160 të Kushtetutës;
- nenin 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- rregullat e përcaktuara në kreun III të pjesës së dytë të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e aktit normativ.

Akti normativ nr.4, datë 5.2.2021 ka qëllim të ndryshojë buxhetin e vitit 2021, duke pasqyruar në të disa shpenzime të nevojshme dhe urgjente për financimin e procesit të zgjedhjeve për Kuvendin, të cilat do të zhvillohen më 25 prill 2021. Ky akt normativ ndryshon për herë të parë buxhetin e vitit 2021.

Karakteristikat kryesore të aktit normativ janë:

Së pari, ruhen të pandryshuar treguesit kryesorë makroekonomikë, të parashikuar në ligjin nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, si deficitin buxhetor dhe borxhi publik.

Deficiti buxhetor mbetet 6.5 për qind e PBB, ndërsa borxhi publik 78.6 për qind e PBB. Këta tregues janë parashikuar kundrejt rritjes ekonomike prej 5.5 për qind.

Së dyti, shpenzimet e përgjithshme të buxhetit rriten me 3.42 miliardë lekë.

Kjo rritje e shpenzimeve parashikohet në zërat si më poshtë:

- *Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm rriten me 2.42 miliardë lekë. Këto fonde do të përdoren për financimin e projektit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Identifikimi elektronik i zgjedhësve”, i cili do të zbatohet në kuadër të procesit zgjedhor për Kuvendin, që do të zhvillohet së afërmi.*
- *Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave rritet me 1 miliardë lekë, për të mbuluar shpenzimet eventuale shtesë, që mund të nevojiten gjatë procesit të zgjedhjeve të përgjithshme, si dhe shpenzime të tjera shtesë të institucioneve buxhetore.*

Së treti, të ardhurat e përgjithshme të buxhetit rriten me 3.42 miliardë lekë, për të mundësuar financimin e shtesës së shpenzimeve të përgjithshme. Kjo rritje e të ardhurave parashikohet në të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

* * *

Aktualisht, ligji për buxhetin e vitit 2021 parashikon një fond prej 1 miliardë lekësh për përballimin e kostos së zgjedhjeve të këtij viti. Ky fond është pjesë e fondit rezervë të Këshillit të Ministrave. Pas miratimit të aktit normativ, fondi total për zgjedhjet parlamentare parashikohet të jetë 4.42 miliardë lekë, nga të cilat 2.42 miliardë lekë për projektin mbi identifikimin e zgjedhësve dhe 2 miliardë lekë janë fond rezervë i Këshillit të Ministrave. Sipas ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, fondi rezervë krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të paparashikuara, në fazën e përgatitjes së buxhetit.

Gjithashtu, në buxhetin e vitit 2021 parashikohet një fond prej 181.5 milionë lekësh për funksionimin e KQZ. Buxheti i KQZ për vitin 2021 (pa përfshirë fondin rezervë) parashikohet të jetë rreth 2.6 miliardë lekë.

Procedurat për përcaktimin e fondit për projektin “Identifikimi elektronik i zgjedhësve”.

Këshilli i Ministrave, në përcaktimin e këtij fondi, është mbështetur në kërkesën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili ka zhvilluar procedurat e prokurimit publik dhe ka kualifikuar si fituese shoqërinë “Smartmatic International Holding B.V.”, me vlerë të ofertës rreth 20 milionë USD ose rreth 2 miliardë lekë pa TVSH. Vlera totale e prokuruar për realizimin e projektit “Identifikimi elektronik i zgjedhësve” është rreth 2.42 miliardë lekë, ku përfshihen edhe TVSH dhe detyrimet e mundshme doganore. Kjo vlerë nuk përballohet nga buxheti i KQZ për vitin 2021.

Sipas nenit 70 të vendimit nr.914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, KQZ mund të lidhë kontratën me operatorin fitues vetëm pasi të jenë në dispozicion fondet buxhetore.

Duke qenë se realizimi i këtij projekti paraqet rëndësi të veçantë për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, është parashikuar që financimi i tij të realizohet përmes shtesës së të ardhurave dhe shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit.

IV. Miratimi i ndryshimeve me akt normativ.

Prej vitesh është bërë praktikë që ndryshimet në buxhetin vjetor të bëhen me akt normativ të Këshillit të Ministrave. Kjo praktikë mbështetet në nenin 101 të kushtetutës, i cili përcakton si kërkesa për nxjerrjen e aktit normativ ekzistencën e disa kushteve, si nevojën, urgjencën dhe përkohshmërinë e masave të propozuara, si dhe detyrimin për miratimin e aktit normativ nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

Në rastin konkret, ndryshimet janë të nevojshme dhe urgjente, pasi synojnë të financojnë shpenzimet për procesin zgjedhor të 25 prillit 2020.

Paraqitja e ndryshimeve buxhetore me akt normativ është shqyrtuar, ndër vite, edhe nga Gjykata Kushtetuese. Në vendimet nr.24, datë 10.11.2006 dhe nr.23, datë 16.4.2014, kjo Gjykatë është shprehur se ndryshimet buxhetore mund të paraqiten me akt normativ të Këshillit të Ministrave, në rastet kur plotësohen kërkesat kushtetuese përkatëse.

V. Diskutimi në Komision.

Ministrja e Financave paraqiti aktin normativ, i cili synon plotësimin e detyrimeve të Këshillit të Ministrave lidhur me zbatimin e Kodit të ri Zgjedhor, të miratuar së fundmi. Ky akt normativ u bazua në kërkesën e KQZ, të datës 20 janar 2021, për shtesë fondi lidhur me realizimin e projektit për identifikimin elektronik të zgjedhësve. Shtesa e fondit bëhet me qëllim që ky projekt të realizohet në kohën e duhur dhe optimale.

* * *

Z. Anastas Angjeli, në cilësinë e relatorit, paraqiti opinionin e tij për aktin normativ, duke e konsideruar atë shumë të rëndësishëm për plotësimin e kushteve lidhur me organizimin e zgjedhjeve të lira, demokratike dhe në përputhje me standardet europiane. Mbështetja me financim e procesit zgjedhor do të ndihmojë në zbatimin e kërkesave të Kodit Zgjedhor, duke mundësuar vazhdimin e shtetit shqiptar në rrugën e demokracisë dhe të integritit në BE. Ndryshimet buxhetore, të parashikuara në aktin normativ të Këshillit të Ministrave, janë të domosdoshme, pasi mundësojnë procesin e identifikimit elektronik të zgjedhësve, i cili është mjaft i rëndësishëm për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Këto ndryshime mbështeten në procedurat ligjore të prokurimit publik, të kryera nga KQZ dhe janë të domosdoshme për lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik fitues të garës, si dhe për ecurinë e mirë të procesit zgjedhor.

Në përfundim, relatori paraqiti disa rekomandime për të bërë të mundur realizimin e objektivave buxhetore për vitin 2021, siç janë:

- Zgjerimi i bazës së taksave;
- Thëllimi i luftës kundër informalitetit dhe evazionit fiskal;
- Reduktimi i përjashtimeve nga taksat;
- Rishikimi i taksave e tarifave, në funksion të mbrojtjes së mjedisit;
- Thjeshtimi i sistemit të taksave;
- Zbatimi me korrektësi i procesit të fiskalizimit;
- Rritja e pavarësisë dhe kapaciteteve të administratës tatimore;
- Forcimi i kuadrit legjislativ, për të modernizuar e thjeshtuar mbledhjen e taksave.

Gjithashtu, përmirësimi i cilësisë së shpenzimeve dhe rritja e efektivitetit të tyre duhet të jenë në fokus të të gjitha strukturave buxhetore.

Një ndër çështjet kryesore, të diskutuara në mbledhjen e Komisionit, ishte mundësia e strukturave ekzekutive për të realizuar objektivin ambicioz lidhur me mbledhjen e të ardhurave nga TVSH, pas shtesës së planit me këtë akt normativ. Ministrja e Financave informoi Komisionin se gjatë vitit 2020, të ardhurat nga TVSH, megjithëse nuk u realizuan sipas planit për shkak të goditjeve të tërmetit dhe pandemisë shëndetësore, arritën një performancë të kënaqshme. Shtesa e të ardhurave nga TVSH, e parashikuar në këtë akt normativ, mbështetet në masat që janë ndërmarrë e po ndërmerren për përmirësimin e administrimit fiskal. Këto masa janë miratuar me akte juridike dhe tani po vijohet me masat përmes instrumenteve financiare, për të arritur një performancë të mirë në mbledhjen e të ardhurave.

Gjatë diskutimit, shumica e anëtarëve të Komisionit e mbështetën aktin normativ dhe u shprehën dakord për miratimin e tij.

VI. Përfundim.

Mbështetur në argumentet si më lart, Komisioni e miratoi aktin normativ nr.4, datë 5.2.2021, të Këshillit të Ministrave me shumicë votash.

KRYETARI

Anastas ANGJELI